



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1961/ 6 prot

Datë 30/07/2024

V E N D I M

K.P.P. 974/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30/07/2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes për ankesën e operatorit ekonomik “Caushi M” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-06981-05-28-2024, me objekt “Rikostruksion rruge në Njësinë Administrative Ishëm” me fond limit 16,665,708.19 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Caushi M*” SHPK me Nipt L884198010 me adresë Ballsh-Mallakastër, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati I-rë, zonat kadastrale 1090, nr. Pasurie, Fier

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës
Sheshi “Iliria”, Durrës

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29-05-2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-06981-05-28-2024, me objekt “Rikostruksion rruge në Njësinë Administrative Ishëm” me fond limit 16,665,708.19 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 13.06.2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 03.07.2024 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave për vlerat pa TVSH si më poshtë:

1. VARAKU E SHPK	10'645'500 lekë	kualifikuar
2. CAUSHI M SHPK	10'672'000 lekë	skualifikuar
3. 2N shpk	10'998'000 lekë	kualifikuar
4. KOMBEAS sha	11'020'000 lekë	kualifikuar
5. GLAVENICA SHPK	11'085'700 lekë	kualifikuar
6. LAÇAJ SHPK	11'184'278 lekë	skualifikuar
7. NIKA shpk	11'389'910 lekë	skualifikuar
8. Rruga Ura Asfaltim nr.2 Elbasan shpk	11'486'188.40 lekë	kualifikuar
9. L.T.E CONSTRUCTION shpk	11'655'500 lekë	skualifikuar
10. AIDA CONSTRUCTION shpk	11'766'350 lekë	kualifikuar
11. S P E K T R I shpk	11'933'250 lekë	skualifikuar
12. RSM COMPANY	12'305'700 lekë	kualifikuar
13. VISCONS GROUP & I.C.C GROUP	12'366'000 lekë	skualifikuar
14. INA shpk	12'491'750 lekë	kualifikuar
15. AL-BASALT shpk & BAMI HOLDING shpk	13'324'898.40 lekë	kualifikuar
16. SARK shpk	13'359'500 lekë	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se më datë 11.07.2024 është publikuar Njoftimi fituesit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Operatori ekonomik “Caushi M” SHPK rezulton i skualifikuar me arsyen si më poshtë vijon:

- Për ofertuesin CAUSHI M me NIPT L884198010, me vlerë të ofertës 10'672'000 lekë, dhe oferte ekonomike të korigjuar në vlerën 10'684'000 lekë, Komisioni i Vleresimit të Ofertave, nëpërmjet anetareve L. F dhe B. M, gjatë shqyrtimit dhe vleresimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik CAUSHI M: 1. Nuk përmbush pjesën e tretë të shtojcës 8, “Kriteret e përzgjedhjes së kualifikimit”, paragrafi D “Deklaratë mbi mos angazhimin e kapaciteteve teknike në kontratat e tjera” të kriterëve të vecanta të kualifikimit, si dhe mbështetur në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pasi ofertuesi deklaroi se drejtuesin teknik nuk e ka të angazhuar në kontrata të tjera. Nderkohe drejtuesi teknik është i angazhuar në kontratën publike me objekt “Rikualifikim hapsira publike në lagjen nr.13 dhe nr.6”, e cila është në proces zbatimi. Mbështetur në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, KVO, nëpërmjet anetareve L. F dhe B. M, vendos që ofertuesi CAUSHI M të mos kualifikohet”.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 17.07.2024 operatori ekonomik “Caushi M” SHPK nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2024/4337, datë 17.07.2024 dhe me Nr.1961/2024 Prot., për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-06981-05-28-2024, me objekt “Rikonstruksion rruge në Njësinë Administrative Ishëm” me fond limit 16,665,708.19 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Caushi M” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1961/2 prot., datë 18.07.2024 referuar pretendimeve mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit, të operatori ekonomik ankimues “Caushi M” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Me shkresën nr. 3329/7 prot., datë 29.07.2024 protokolluar me tonën me nr. 1961/3 prot., datë 30.07.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Caushi M” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i plotë i ankesës.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ nuk rezulton, të jenë dorëzuar argumente nga subjektet të interesuara në përputhje me nenin 113 të LPP-së, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Caushi M” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me shkresën nr. 3329/7 prot., datë 29.07.2024 protokolluar me tonën me nr. 1961/3 prot., datë 30.07.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Caushi M” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur pranimi i plotë i ankesës duke argumentuar: “[...]Lidhur me pretendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave që drejtuesi teknik është i angazhuar në kontratën publike me objekt “Rikualifikim hapësira publike në lagjen nr. 13 dhe nr. 6” e cila është në proces zbatimi, sqarojmë se me shkresën me nr. 43/2 prot., datë 07.06.2024, Shoqëria GB Civil Engineering shpk në cilësinë e mbikqyrësit të punimeve, ka njoftuar Bashkinë Durrës për përfundimin e punimeve në lagjen nr. 13 dhe në sheshin pranë Rifat Peshkatarit sipas preventivit të miratuar. Data e përfundimit të punimeve në lagjen nr. 13 dhe në sheshin pranë Rifat Peshkatarit është data 22.05.2024.

Përsa i përket punimeve në lagjen nr. 6, sqarojmë se me shkresën me nr. 02/6 prot., datë 20.05.2024 të Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike është miratuar pezullimi i punimeve për shkak të mos pajisjes së subjektit nga AK, Bashkia Durrës me Deklaratën Paraprake për kryerjen e punimeve.

Në këto kushte gjucojmë se, edhe pse nuk kërkohet në DT, tek krieteret e veccanta të kualifikimit, mosangazhimi i stafit teknik në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, “defacto”, ky staf nuk është i angazhuar.

Lidhur me ankesën e sipërcituar KSHA vlerëson se pretendimi i ofertuesit ankimues qëndron dhe ankesa duhet pranuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 114 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, urdhër nr. 255, datë 24.07.2024 “Për shqyrtimin e ankesës për procedurën e prokurimit me objekt “rikonstruksion rruge në Njësinë administrative Ishëm”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës njëzëri,

Vendosi

Pranimin e plotë të ankesës së ofertuesit “Caushi M” SHPK me NIPT L884198010 për kontratën me numër të referencës Nr. REF-06981-05-28-2024 me objekt “Rikonstruksion rruge në Njësinë Administrative Ishëm”... [...]

II.1.2. Neni 30, e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115, pika 1 dhe 2, e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik argumente në kuptim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe për këtë fakt, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Caushi M” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-06981-05-28-2024, me objekt “Rikostruksion rruge në Njësinë Administrative Ishëm” me fond limit 16,665,708.19 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Caushi M” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

